 Tel +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax E-Mail: info@dpa.gov.al	Politika e DPA në lidhje me kompetencën teknike të inspektorëve që kryejnë inspektimin e mjeteve motorike në zbatim të standardit ISO/IEC 17020 :2012.	KodiDA-PO-018
		Rishikim nr 0
		Dt:11.07.2018
		Faqe 1 nga4


Politika e DPA në lidhje me kompetencën teknike të inspektorëve që kryejnë inspektimin e mjeteve motorike në zbatim të standardit ISO/IEC 17020 :2012

Hartoi

Ardita MELE

Miratoi:

Armond HALEBI

 <p> Tel +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax E-Mail: info@dpa.gov.al </p>	Politika e DPA në lidhje me kompetencën teknike të inspektorëve që kryejnë inspektimin e mjeteve motorike në zbatim të standardit ISO/IEC 17020 :2012.	KodiDA-PO-018
		Rishikim nr 0
		Dt:11.07.2018
		Faqe 2 nga 4

1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në lidhje me kompetencën teknike të inspektorëve që kryejnë inspektimin e mjeteve motorike në zbatim të standardit ISO/IEC 17020 :2012.

2. Referimet

ISO/IEC 17011 “Kërkesa të përgjithshme për organizmat e akreditimit që akreditojnë organizmat e vlerësimit të konformitetit”, paragrafi 7.3.1

ISO/IEC 17020:2012 "Kërkesa për funksionimin e tipeve të ndryshme të trupave që kryejnë inspektim"

Udhëzuesi EA 5/02: 2015 "EA Guidance on the Application of ISO/IEC 17020 in Periodic Inspection of the Roadworthiness of Motor Vehicle sand theirTrailers".

Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë dhe aktet nënligjore në lidhje me të.

3. Kërkesat teknike


3.1 Kryevlerësuesit, vlerësuesit teknik dhe stafi vendimmarrës i DPA do të vlerësojnë plotësimin e kërkesave të S SH ISO/IEC 17020:2012 për rastin e inspektimit të mjeteve motorike duke u bazuar edhe në udhëzuesin EA 5/02.

3.2 Për plotësimin e kërkesës 6.1.3 dhe 6.1.6 pika a dhe c të standardit ISO/IEC 17020:2012, inspektorët të cilët kryejnë aktivitete inspektimi të mjeteve motorike përveç kërkesave të dhëna në nenin 80 pika 1 dhe 2 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

3.2.1 Njohuritë:

Në varësi të inspektimit që kryejnë dhe vendit të punës, inspektorët duhet të kenë njohuri të demonstruara në fushat e mëposhtme:

— mekanike;

 <p>Tel +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Politika e DPA në lidhje me kompetencën teknike të inspektorëve që kryejnë inspektimin e mjeteve motorike në zbatim të standardit ISO/IEC 17020 :2012.</p>	<p>KodiDA-PO-018</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0</p> <p>Dt:11.07.2018</p> <hr/> <p>Faqe 3 nga4</p>
--	--	---

- dinamike;
- dinamike të mjeteve motorike;
- motorëve me djegie;
- materialeve dhe përpunimin e materialeve;
- elektronikes;
- elektrike;
- komponentëve elektronik të mjeteve motorike;
- Programeve të teknologjisë së informacionit;


Siç referohet edhe në nenin 80 të Kodit Rrugor, inxhinierë mekanikë të diplomuar ose teknikë mekanikë transporti presumohet se i plotësojnë kriteret e lartpërmendura.

3.2.2 Trajnimet:

Stafi teknik i trupës inspektuese duhet të jetë i trajnuar fillimisht ose nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ose nga organizma që ofrojnë trajnime për këtë fushë, ose ka trajnime të brendshme nga inxhinier mekanik ose mekanik transport që kanë mbi 3 vjet eksperience pune në fushën e inspektimit të mjeteve të transportit rrugor. Gjithashtu, trupa inspektuese duhet të trajnojnë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë inspektorët e saj. Temat e trajnimit duhet të jenë në përputhje me inspektimin që inspektori kryen. Pas çdo trajnimi, inspektorët duhet të kenë kaluar një provim teorik dhe praktik për të vlerësuar efektivitetin e trajnimit.

Trajnimi duhet të përmbajë të paktën temat e mëposhtme:

- (i) Teknologjia e mjeteve motorike ku përfshihen: sistemet e frenimit, sistemet e drejtimit, instalimi i dritave, pajisjet e ndricimit dhe komponentët elektronik, akset, rrotat, shasia, etj
- (ii) metodat e testimit dhe inspektimit;
- (iii) vlerësimi i mangësive;
- (iv) kërkesat ligjore në lidhje me kriteret që duhet të plotësojnë mjetet motorike;

 <p> Tel +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax E-Mail: info@dpa.gov.al </p>	Politika e DPA në lidhje me kompetencën teknike të inspektorëve që kryejnë inspektimin e mjeteve motorike në zbatim të standardit ISO/IEC 17020 :2012.	KodiDA-PO-018
		Rishikim nr 0
		Dt:11.07.2018
		Faqe 4 nga4

(v) kërkesat ligjore në lidhje me testimet dhe inspektimet që duhet të kryhen

(vi) kërkesat administrative në lidhje me rregjistrimet e testeve dhe inspektimeve

(vii) Administrimin e rregjistrimeve duke përfshirë edhe ato elektronike.

Për trajnimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ose nga organizma që ofrojnë trajnime në këtë fushë certifikata e trajnimit duhet të jetë e lëshuar prej tyre dhe duhet të jetë e identifikuar qartë, emri i personit të trajnuar, lloji i trajnimit të kryer, programi i trajnimit dhe data e lëshimit.

Për trajnimet e brendshme, dokumenti i kualifikimit të cdo inspektori duhet të përmbajë emrin e personit të trajnuar, numrin rendor të dokumentit, personin që ka kryer trajnimin, datën e trajnimit, programin e trajnimit.

3.2.3 Eksperienca në punë:

Drejtuesi teknik dhe inspektorët të këtë të paktën 3 vjet eksperience të dokumentuar në fushën e inspektimeve ose të mirëmbajtjes së mjeteve të transportit rrugor ose të ekuivalentuar me eksperiencë në mësim dhënie ose studime të tjera në lidhje me mjetet motorike dhe që njëkohësisht plotëson kërkesat e pikës 3.2.2 të kësaj politike.